

264
06-02-2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST

Tiranë, më 01. 02. 2019

Drejtuar: **Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

Prof. Dr. Agron CUKA

Lënda : **Raporti i Punës për Muajin Janar i NJSBC-së pranë UST.**

R A P O R T

Gjatë muajit Janar 2019 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga: Prof. Dhimitraq Stratobërdha (Kryetar), Dr. Mirjeta Cenaj dhe Doc. Anduela Lile (Anëtarë) në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2018-2019 ka vazhduar punën për të marrë informacione nga njësitë kryesore, administrata e UST dhe për programet e fakulteteve të UST.

Është punuar me Manualin e ASCAL për të qenë në punën tone konform standardeve të kërkuara, në lidhje me dokumentacionin e kësaj njësie e në përputhje me ligjin e aktet e tjera nënligjore.

Kemi hyrë në fazën e dytë të vlersimeve, që është edhe më e rëndësishmja e që duhet tu përgjigjet standardeve ku do të arrijë cdo IAL.

Konkretisht nga ana jonë, gjatë këtij muaji, u përgatit një pyetsor për studentët e UST për të tërhequr mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit.

Pasi u përgatitën, iu shpërndanë studentëve dhe janë duke u mbledhur pyetsoret nga gjithë programet e UST deri në fillimin e sezonit provimeve, afati kohor është lënë deri dt 10.02.2019.

Ky pyetsor është ndërtuar në mënyrë të tillë, që të mund të bëhen krahasime me mendimet e opinionet e studentëve vitin e kaluar.

Ky raport është përgatitur sipas pikes 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03. 2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari I NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha